



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:026105
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05595508

P.nr.95/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Mersiha Calakovic Pllana, me bashkëpunatoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurve: N.S dhe S.H, për shkak të veprës penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP-II.nr.93/24, të datës 19.03.2024, të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 02.04.2024, në prezencën e prokurores së shtetit në PTH në Mitrovicë, Albana Parduzi, të pandehurve N.S dhe S.H dhe mbrojtësve të tyre, av.Fatmire Bunjaku Klisurica dhe av.Rexhep Kaçaniku, më datë 04.04.2024 shpalli publikisht, ndërsa më datë 19.04.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve:

1.N.S, me nofkën “...”, nga i ati H..., e ëma S..., i lindur më datë, në M..., me adresë të vendbanimit në rrugën “...”, në M..., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit, rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.S.H, nga i ati Q..., e ëma H..., e vajzërisë S..., i lindur më datë, në M..., me adresë të vendbanimit në rrugën “...”, në M..., i martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit, rom, shtetas i Republikës së Kosovës, të njëjtit;

JANË FAJTOR

I

Sepse:

Më datë 13.01.2024 rreth orës 20:20 min në Mitrovicë Veriu, rrugën “Knjez Milloshi”, me dashje, në bashkëkryerje, dhe atë në mënyrë të vrazhdët, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete, deri sa e dëmtuara T.N, ka qenë duke ecur rrugës, e përcjellin të njëjtën ashtu që i pandehuri S.H vëzhgon ndërsa i pandehuri N.S i afrohet të njëjtës nga prapa dhe me forcë ja kap çantën e krahut të cilës i këputet zingjiri i çantës dhe me të marrë çantën ikin së bashku dhe shkojnë tek Ura Ibrit, poshtë saj e hapin çantën në të cilën kanë qenë komplet dokumentacionin, letërnjoftimin e Serbisë, librezën shëndetësore, dy (2) kartela të bankës, një (1) kartelë studentore dhe një të rëndomtë, rreth 3500 dinarë – përafërsisht 30 €, portofoli i cili kushton rreth 80 € dhe çanta rreth 20 €, duke u larguar, pastaj i marrin të hollat ndërsa çantën dhe dokumentet i fshehin poshtë urës, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës dëme materiale në vlerë 3500 dinarë.

II

Më datë 22.01.2024 rreth orës 17:50 min në Mitrovicë Veriu, rrugën “Knjez Millosh” me dashje dhe në bashkëkryerje, në vazhdimësi, dhe atë në mënyrë të vrazhdët, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete, ashtu që deri sa e dëmtuara J.J kishte qenë duke ecur rrugës, fillimisht e përcjellin deri sa i pandehuri S.... e vëzhgon ndërsa i pandehuri N.... për një moment i afrohet të dëmtuarës nga prapa dhe me forcë ja kap çantën e krahut “Mona” në të cilën ka pasur letërnjoftimin e saj, letërnjoftimin e nënës të Kosovës, kodin për pasaportë të Kosovës, letërnjoftimin e Serbisë, lejen e vozitjes, librezën e shëndetësisë dhe kartelën e bankës, pastaj ikin që nga aty në drejtim të “Urës së Ibrit” dhe poshtë saj e hapin çantën dhe aty i fshehin dokumentet.

III

I pandehuri N.S me datë 20.01.2024 rreth orës 22:20 në Mitrovicë të Veriut, në rrugën “Knjez Millosh” saktësisht tek restoranti “Bishevac” me dashje, në mënyrë të vrazhdët dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete, deri sa ka qenë e dëmtuara R.L duke shkuar në shtëpi tek rrethi ndërmjet rrugës “Knjaz Millosh” dhe “Kral Petri”, i pandehuri i shkon pas dhe nga prapa i’a kishte kapur çantën e krahut të cilën ishte munduar të mos i’a lëshojë mirëpo nuk kishte arritur të rezistoj gjatë dhe i pandehuri i’a merr çantën në të cilën kishte pasur letërnjoftimin dhe patentë shoferin e Kosovës, letërnjoftimin e Serbisë, kartela bankare, telefonin

“Redmi” ngjyrë e kaltër me IMEI-86942105845285 në vlerë prej 280 euro si dhe 4000 dinar të Serbisë duke ik nga vendi i ngjarjes, duke i shkaktuar dëm të dëmtuarës në vlerë 400 dinar.

Me këtë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 31, 38, 40, 42, 43, 71, 72, 77, 79, si dhe nenit 315 të KPRK-së, dhe nenit 358, 364, 449, 462 të KPP-së, ju:

S H Q I P T O N

Të pandehurit N.S

-DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti e tetë (8) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej treqind (300) euro, të cili dënim - gjobë duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të i'a zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

Të pandehurit S.H

-DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej treqind (300) euro, të cili dënim - gjobë duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të i'a zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

-NDËRPRITET MASA E PRABURGIMIT dhe të njëjtit lirohen menjëherë që të mbrohen në liri, nga data 04.04.2024.

-Koha e kaluar në masën e paraburgimit për secilin nga të pandehurit, nga data 22.01.2024 deri me datë 04.04.2024, u llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

-Obligohen të pandehurit që secili veç e veç, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

- Palët e dëmtuara, R.I, J.J dhe T.N, udhëzohen në kontest të rregullt civil, lidhur me kërkesën pasurore - juridike.

A r s y e t i m i

Aktakuzë:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP-II.nr.93/24, të datës 19.03.2024, ndaj të pandehurve: N.S dhe S.H, për shkak të veprës penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Më datë 02.04.2024, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Albana Parduzy, të dëmtuarës T. N, të pandehurve N.S dhe S.H dhe mbrojtësve të tyre av.Fatmire Bunjaku Klisurica dhe av.Rexhep Kaçaniku.

Të pandehurit, në seancën e shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata, me të drejtat e tyre në këtë fazë të procedurës penale, janë deklaruar dhe kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë. Ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur dhe premtuan gjykatës se më nuk do të kryejnë veprime të tilla.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Prokurorja e shtetit Albana Parduzy, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi është bërë konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së, në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit me mbrojtësit e tyre, si dhe pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes që përmban kjo aktakuzë. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit është shprehur se qëndron pas pikës IV të aktakuzës, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese ka propozuar që gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e shprehur nga të pandehurit.

E dëmtuara T.N, propozoi që gjykata të pranoj pranimin e fajësisë të deklaruar nga të pandehurit.

Mbrojtësja e të pandehurit N.S, av.Fatmire Bunjaku Klisurica, fillimisht ka kërkuar nga gjykata që të miratohet pranimi i fajësisë dhe pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese të merret po ashtu fakti se klienti i saj ka treguar sjellje të mira, ka bashkëpunuar me organet e rendit që nga fillimi i procedurës penale, ku falë këtij bashkëpunimi janë gjetur edhe sendet e vjedhura dhe i janë kthyer palëve të dëmtuara, mosha e tij e re, rrethanat familjare, pasi që është mbajtës i familjes, babi i një fëmije, pastaj gjendjes e tij ekonomike, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur dhe premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla. Bazuar në këto nga gjykata ka kërkuar që të zbatohen dispozitat e nenit 71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënimi nën minimumin e paraparë ligjor, duke kushtëzuar dënimin e shqiptuar.

Mbrojtësi i të pandehurit S.H, av.Rexhep Kaçaniku, gjykatës i propozoi që të miratohet pranimi i fajësisë. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, ka theksuar se i mbrojturi i tij ka probleme ekzistenciale në shtëpinë e tij, nënën e sëmur, ka bashkëpunuar me policinë ashtu që sendet e marra në mënyrë të kundërligjshme i janë kthyer të dëmtuarve, ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur dhe ka premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla. Në bazë të këtyre gjykatës i propozoi që të aplikohen dispozitat e zbutjes së dënimit dhe të njëjtin ta dënoj nën minimumin e paraparë ligjor, kështu duke shqiptuar një dënim të kushtëzuar.

Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e kanë deklaruar të pandehurit N.S dhe S.H, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimi të fajësisë për të pandehurit. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga të pandehurit mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raportet policore të datave 22.01.2024, 13.01.2024 dhe 21.01.2024; Raportet fillestare të incidentit të datave 22.01.2024, 13.01.2024 dhe 20.01.2024; Raportet e shpejta të datave 22.01.2024 dhe 13.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarës T.N, i datës 13.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje e të dëmtuarën J.J, i datës 22.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje e të dëmtuarën R.L, i datës 20.01.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje e të pandehurin S.H, i datës 15.01.2024 dhënë në hetuesi si dhe më datë 02.02.2024 dhe 29.02.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje e të pandehurit N.S, më datë 22.01.2024 dhënë në hetuesi si dhe në prokurori më datë 02.02.2024 dhe 29.02.2024; Fotoalbumet nga shkresat e lëndës; CD-ja; Vërtetimet mbi konfiskimin e sendeve i datës 22.01.2024 për rastin 2024-SA-23 si dhe për rastin 2024-SA-10, si dhe i datës 23.01.2024 për rastin 2024-SA-19; Vërtetimet mbi kthimin e sendeve të datës

23.01.2024 për rastin 2024-SA-23, pastaj për rastin 2024-SA-10, si dhe për rastin 2024-SA-19; Informacionet mbi të kaluarën kriminale në emër të pandehurve; si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga të pandehurit, përtej çdo dyshimi vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata i'a kishte tërheq vërejtjen të pandehurve se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, të njëjtit janë njoftuar se nëse e pranojnë fajësinë humbasin mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se të pandehurit N.S dhe S.H janë të përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohen: Vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Gjykata, ka pas parasysh edhe faktin se prokuroria pas çdo përshkrimi të gjendjes faktike e ka cekur edhe kualifikimin ligjore, dhe atë vjedhje e rëndë në vazhdim. Në këtë drejtim, Gjykata e ka parasysh se në rastin kur kemi vepër penale në vazhdim, atëherë kemi vetëm një vepër penale, pra vepër penale në vazhdim, për çka edhe kualifikimin ligjor pas secilit dispozitiv e ka larguar. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet nga neni 77 i KPRK-së, i cili kërkon që në rastin e veprës penale në vazhdim, të plotësohen së paku dy kushtet, ashtu që në rastin konkret Gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që kanë të bëjnë me objektin e njëjtë të veprës, pra pasuria, pastaj dashja e njëjtë e kryerësit, e që është përvetësimi për vetën i pasurisë së huaj, por edhe elementi tjetër i periudhës kohore, ashtu që të gjitha veprat janë kryer brenda një periudhe të shkurtë kohore, respektivisht brenda 20 ditëve. Prandaj, edhe janë plotësuar kushtet për vepër penale në vazhdim. Po ashtu, edhe fakti se vepra si në pikën III, është kryer

vetëm nga i akuzuari N.S, e që nuk ka qenë i përfshirë i akuzuari tjetër, prapë Gjykata e ka cilësuar si vepër në vazhdim, duke u nisur nga fakti se është më e favorshme për të akuzuarin, ngase gjykohet vetëm për një vepër, por që kjo i është marrë si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit. Ndërsa, i akuzuari S.H, është përfshirë në pikën I dhe II, për çka edhe është plotësuar kushti për vepër penale në vazhdim.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit N.S dhe S.H, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese ka vlerësuar, shkallën e përgjegjësisë penale, pra dashjen e tyre në kryerjen e veprës penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tyre në veprën penale. Po ashtu, në raport me të akuzuarin N.S, si rrethanë rënduese është marr edhe fakti se është i përfshirë në tri raste të vjedhjes.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se të njëjtit kanë treguar sjellje të mira, keqardhjen e shprehur nga të pandehurit në seancë gjyqësore dhe premtimin e tyre se më nuk do të përsërisin veprime të tilla, bashkëpunimin plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tyre, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, gjendjen e tyre të rënduar ekonomike. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurit është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti.

Gjykata, në kuptim të nenit 71 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenin 71 par.1, nën-par.1.3 të KPRK-së, që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 par.1, nën-par. 1.3 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, dënimi i shqiptuar me burgim dhe me gjobë, ndaj të pandehurve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Po ashtu, gjykata vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së,

që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Ndërprerja e masës së paraburgimit:

Gjykata, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që të pandehurve u'a ka ndërprerë masën e paraburgimit, me rastin e shpalljes së aktgjykimit. Në lidhje me këtë Gjykata ka lëshuar vendim të veçantë ku edhe i ka dhënë arsyet për një vendim të tillë.

Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar:

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që të pandehurve kohën e kaluar në masën e paraburgimit, nga data 22.01.2024 deri me datë 04.04.2024, u'a ka llogaritur në dënim e shqiptuar me burgim. Kjo duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së, ku përcaktohet se koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Shpenzimet procedurale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në nenin 462 të KPP-së, ashtu që të dëmtuarat i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449 dhe 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.95/2024, datë 19.04.2024

Bashkëpunëtore Profesionale:

Edita Koliqi

Gjyqtarja:

Mersiha Calakovic Pillana

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.